

VENDIM
Nr.351, datë 10.8.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.310 DATË
24.7.1992 "PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E
ÇMIMEVE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave. nr.310, datë 24.7.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin I, në pikën 1, shkronja "c" ndryshon si vijon:

"Personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966", "Për sigurimet shoqërore" dhe sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur këta të fundit janë me banim të përhershëm në qytet, NB e qendra të banuara (të vërtetuara nga organet e pushtetit, bashkia ose komuna), si dhe atyre që marrin pension familjar, sipas ligjeve të mësipërme, kur janë vetëm ose kur janë kryefamiljar.

Në shkronjën "ç" në fund shtohen fjalët "sipas dispozitave në fuqi", si dhe një paragraf me këtë përmbajtje:

"Ndihma ekonomike caktohen nga Këshilli i komunës ose i bashkisë".

2. Në kapitullin II, në fund të pikës 2 shtohen fjalët:

"mbi 0,5 dynym për frymë".

3. Efektet financiare që lindin pas këtij vendimi fillojnë më datën 1 gusht 1992.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi